UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

| | |
|---|---|
| **Study program** | **Studime të Sigurisë (2020/2021)** |
| Fakulteti | Drejtësia |
| Cikli i studimeve | Cikli i dytë (Pasdiplomike) |
| SETK | 60 |
| Kodi | SEC60 |
| Titulli | Magjistër i shkencave juridike - Drejtimi: Studime të sigurisë |
| Numri në arkiv i akreditimit [60] | 03-3292/1 |
| Numri në arkiv i akreditimit [] | |
| Vendimi për fillim me punë | |
| Data akreditimit | 04.11.2020 |

## Përshkrimi i programit

Programi studimor studime të sigurisë synon të ofrojë një gamë të moduleve që do ta përfshijnë bazën e të dijeve ndërkombëtare juridike për afrimin drejt profesionet juridike dhe profesionet që lidhen me lëmin e të drejtës ndërkombëtare dhe të sigurojë njohuri të fuqishme, të veçanta dhe sistematike për institucionet dhe koncepcionet e së drejtës ndërkombëtare, si dhe mbi gjendjen dhe perspektivën e tyre në rajon dhe botë.

## Karriera

Diploma e Fakultetit juridik njihet nga Oda e avokatëve dhe e noterëve në RMV. Titujt profesionalë të avokatëve dhe të noterëve kërkojnë regjistrim formal në këto oda. Diploma e Fakultetit juridik u mundëson studentëve një qasje në organet shtetërore, sidomos në organet gjyqësore si: gjyqësia dhe prokuroritë publike. Fakulteti juridik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë për trajnimin e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë në RMV. Studentëve që do të kenë ambicie të merren me punë hulumtuese shkencore, Fakulteti juridik i UEJL-së, u mundëson vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë (studime të doktoratës). Studentët në këtë program, gjithashtu profesionalisht aftësohen edhe për të gjitha profesionet në fushën e sigurisë nacionale dhe ndërkombëtare, me theks të veçantë të ushtrimit të profesioneve në kuadër të organeve të sistemit të sigurisë në vend.

## Rezultatet e të mësuarit

**Njohuritë dhe të kuptuarit**

- Ka njohuri të avancuara teorike dhe praktike mbi sistemin e sigurisë nacionale dhe i riprodhon njohuritë mbi qëllimet dhe standardet e sigurisë;
- Ka njohuri dhe kuptime specifike mbi masat dhe veprimet preventive dhe represive të sigurisë në kuadër të menaxhimit me situata të krizës dhe mbi prioritetet në fushën e sigurisë;
- Ka njohuri të detajuara mbi kuptimin dhe pranimin e parimeve themelore të etikës profesionale në fushën e sigurisë;
- Ka kuptim specifik mbi teknologjitë dhe metodologjitë e hulumtimit në fushën e sigurisë;

**Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

- I identifikon dhe i zbaton politikat, procedurat dhe rregullat në fushën e sigurisë;
- I identifikon dhe i analizon çështjet më komplekse në fushën e sigurisë, duke marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e implementimit të politikave, të procedurave dhe të vendimeve në fushën e sigurisë dhe në krijimin e standardeve të sigurisë në organizata dhe institucione të fushës së sigurisë;
- I interpreton dhe i diskuton çështjet bashkëkohore komplekse që ndërlidhen me rreziqet, sfidat dhe kërcënimet në fushën e sigurisë;
- Formulon plane, raporte dhe dokumente strategjike në lëmin e menaxhimit me situata të krizës dhe të shfrytëzimit të teknikave e të mekanizmave kontrolluese të standardeve të sigurisë;
- I zbaton njohuritë e përfituara nëpërmjet hulumtimit të procesit të zgjidhjes së çështjeve komplekse dhe praktike të sigurisë;

**Aftësitë për të vlerësuar**

- Merr vendime për zgjidhjen e rasteve më komplekse praktike nëpërmjet hulumtimit të krijimit të politikave, procedurave dhe vendimeve nga fusha e sigurisë;
- I vlerëson dhe i dallon standardet e sigurisë të organizatave dhe të institucioneve nga fusha e sigurisë;
- Ka mendim më të zhvilluar kritik përmes metodës së analizës dhe të krahasimit.

**Aftësitë e komunikimit**

- Përdor terminologji adekuate për çështje komplekse dhe specifike në sferën e sigurisë.
- Angazhohet aktivisht në argumentimin dhe në debatin shkencor.
- I përdor gjuhët zyrtare të universitetit dhe ka shkathtësi të avancuara të teknologjive të informimit në punën shkencore.

**Aftësitë e të mësuarit**

- Zhvillon rregullore të punës kërkimore që përdoret në profesionin e tij.
- Zhvillon një praktikë të mësimit të vazhdueshëm duke u angazhuar në trajnimin e personave që punojnë në shërbimet diplomatike-konsullore të shtetit.

# Lista e lëndëve

## Semestri 1

- [MCCR1220] [6.0 SETK] **E drejta penale materiale**
- [MCCR1040] [6.0 SETK] **Kriminologjia**
- [MCCR2040] [6.0 SETK] **Kriminalistika**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## Semestri 2

- [MCSS4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

# Description of courses

## Lëndë obligative

- **E drejta penale materiale**
  Bazë për mësimdhënie në këtë lëndë janë programet e lëndëve e drejta penale - pjesa e përgjithshme dhe e drejta penale - pjesa e posaçme. Me rastin e zhvillimit të mësimit në këtë lëndë, në vend të metodës tradicionale eks katedra, aktivisht do të zbatohet metoda e studimit të rastit si dhe metoda klinike.

- **Kriminologjia**
  Përvetësimi i njohurive të avancuara mbi lëndën e studimit të kriminologjisë dhe të institucioneve kryesore kriminologjike, çështjet dhe tendencat bashkëkohore si dhe të bëhen studime mbi ndikimin e faktorëve të ndryshëm në kryerjen e veprave penale, ekzaminimet kriminologjike lidhur me kryesin dhe viktimën e veprës penale si dhe identifikimi dhe analizimi çështjeve bashkëkohore kriminologjike.

- **Kriminalistika**
  Specializimi në këtë fushë është i nevojshëm sidomos për ato kuadro që do të punojnë në organet e drejtësisë – në gjykata, prokurori publike dhe në policinë gjyqësore. Kriminalistika në thelbin e saj e ka legjislacionin penal material dhe procedural, si dhe aktet nënligjore që burojnë prej zbatimit të tyre. Çdo qenie ligjore e veprës penale përmban në vete përcaktimin e tërësisë së fakteve dhe të rrethanave që janë relevante për zgjidhjen e gjithanshme dhe të drejtë të rastit penal.

- **Punimi i magjistraturës**
  Kjo lëndë u mundëson studentëve t'i bartin shkathtësitë dhe dituritë e tyre për hulumtimin dhe hartimin e detyrës më të komplikuar - shkrimit të punimit të magjistraturës. Lënda është paraparë që tërësisht të jetë praktike dhe studentët t'i fitojnë dituritë dhe aftësitë, shkathtësitë dhe besimin e nevojshëm që t'i qasen hulumtimit dhe shkrimit të tezës. Lënda ka vetëm një rezultat kthyes – t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë tezën e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me efektivitet maksimal. Gjithçka që është paraparë të bëhet ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe të stilit të shkrimit të tezës së magjistraturës duke pasur kujdes me këtë rast për ndalimin e shërbimit me mjetet e palejueshme siç janë: plagjiatura dhe shkelja e të drejtave të autorit, që ndalohen me Statutin e UEJL-së.

## Lëndë zgjedhore

- **E drejta e kundërvajtjeve**
  Qëllimi i lëndës konsiston në fitimin e njohurive të avancuara për të drejtën e kundërvajtjeve si disiplinë shkencore, si dhe për pjesën materiale dhe procedurale të saj, përfshirë këtu edhe regullimin ligjor të kundërvajtjeve sipas Ligjit për kundërvajtje.

- **Metodika kriminalistike**
  Metodika Kriminalistike është pjesë e veçantë e Taktikës Kriminalistike, e cila i studion mënyrat dhe metodat për zbulimin e llojeve, ose grupeve të veçanta të veprave penale dhe kryerësve të tyre. Kjo disiplinë shkencore gjithashtu studion dallimet që paraqiten gjatë ndërmarrjes së veprimeve hetuese për veprat e ndryshme penale. Në këtë lëndë në mënyrë të veçantë studentët, do të mësojnë për metodikën e zbulimit dhe hetimit të disa veprave penale, si: metodikën e hetimit dhe sqarimit të vrasjeve, kontrabandave të ndryshme, akteve terroriste, aksdienteve të trafikut, korrupsionit, krimet e luftës e kështu me radhë.

- **Viktimologjia**
  Problematika e viktimës, procesi i viktimizimit, rritja e numrit të njerëzve që janë të rrezikuar nga viktimizimi, kompensimi demit dhe prevenca e viktimitetit janë temat kyçe të kësaj lënde, për shkak se viktimizimi dhe mbrojtja e viktimave paraqesin një preokupim të madh të shoqërisë moderne.

- **Penologjia**
  Përvetësimi i njohurisë për lëndën e studimit të penologjisë dhe të institucioneve kryesore penologjike, probleme dhe tendenca si dhe studimi i ndikimit të faktorëve të ndryshëm në ekzekutimin e sanksioneve penale, ekzaminimet penologjike lidhur me dënimet e shqiptuara për veprat penale, si identifikimi dhe analizimi i çështjeve bashkëkohore penologjike.

- **E drejta procedurale penale**
  Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri solide teorike dhe praktike për dispozitat procedurale penale dhe për institutet me të cilat është e rregulluar ligjërisht veprimtaria e autoriteteve procedurale dhe e pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale, si dhe të aftësohen për zbatimin praktik të tyre.

- **Delikuenca e të miturve**
  Delikuentët e mitur janë në lidhje të ngushtë edhe me fenomenet e tjera socio-patologjike, siç janë: narkomania, alkooolizmi dhe prostitucioni, dukuri që sot përhape pothuajse në çdo vend në botë, dhe, për fat të keq, ato janë të pranishme edhe në vendin tonë. Prandaj, qëllimi themelor i kësaj disipline është të zbulohen dhe të evidentohen format e reja të kësaj dukurie kriminale dhe të shpjegohen shkaqet për praninë e tyre në mënyrë që të propozohen masat e duhura për parandalim dhe represion.

- **E drejta penale krahasuese e të miturve**
  Lënda trajton sistemet penale ndaj fëmijëve në vende të ndryshme, përmes një analize sistematike të zgjidhjeve të ligjeve penale në kontekstin e harmonizimit të tyre me Konventën e KB për të drejtat e fëmijëve.

- **Krimi i organizuar**
  Krimi i organizuar, si një disiplinë e re shqyrton format, shkaqet dhe masat për parandalimin dhe eliminimin e krimit të të gjitha llojeve dhe sferave. Rëndësi e veçantë u jepet teorive të krimit të organizuar, organizatave kriminale dhe formave të manifestimit.

- **Teknikat dhe taktikat kriminalistike**
  Specializimi në këtë fushë është i nevojshëm sidomos për kuadrin që do të punojë në organet e drejtësisë-gjykata, prokurori publike dhe në policinë gjyqësore. Kriminalistika në thelbin e saj e ka legjislacionin penal material dhe procedural dhe aktet nënligjore që dalin prej tyre. Çdo figurë ligjore e veprës penale përfshin përcaktimin e tërësisë së fakteve dhe të rrethanave që janë relevante për zgjidhjen e gjithanshme dhe të drejtë të rastit penal.

- **Psikologjia kriminalistike**
  Kjo disiplinë ka karakter ndihmës për shkencat tjera juridike penale me qëllim të vlerësimit psikologjik të së vërtetës dhe të gënjeshtrës në procesin gjyqësor penal ndaj të pandehurve, dëshmitarëve dhe personave të tjerë në procedurën penale përmes vlerësimit psikologjik të deklaratave dhe veprimeve të tyre.

- **Kriminaliteti kompjuterik**
  Studentët do të fitojnë njohuri të avancuara mbi llojet më të reja të veprave penale që kryhen përmes kompjuterëve dhe rrjeteve të internetit si dhe me mënyrat bashkëkohore të parandalimit të krimit të tillë, që po zhvillohet gjithnjë e më shumë në shoqëritë e sotme digjitale. Do të analizohen krime të tilla si: mashtrimet kompjuterike, falsifikimet e suftuerit kompjuterik, si format e tjera të abuzimit të internetit për qëllime kriminale etj. Do të analizohet legjislacioni vendor i posareformuar dhe ndërkombëtar dhe do të fitohen njohuri mbi standardet dhe rrjedhat botërore në këtë lëmi.

- **Etika në kriminalistikë**
  Etika në kriminalistikë është pjesë e etikës së përgjithshme që trajton çështjen si, me masat parandaluese dhe represive, të mbrohet komuniteti nga krimi në mënyrë profesionale dhe efikase, duke respektuar parimet kushtetuese dhe ligjore të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarëve. Kjo lëndë është e rëndësishme për shkak se puna e policisë trajtohet si një profesion. Etika dhe standardet etike luajnë një rol të madh në mënyrën e ushtrimit të profesionit.

- **E drejta policore**
  E drejta policore studion të drejtën administrative që ka të bëjë me punët e brendshme. Ajo përkufizohet si një tërësi rregullash juridike që përcaktojnë organizimin, funksionet dhe organet e punëve të brendshme, marrëdhëniet e ndërsjella dhe marrëdhëniet me autoritetet e tjera, me organizatat, qytetarët dhe procedurat e veçanta dhe me metodat e punës në fushën e punëve të brendshme, kur kryhen punë administrative që nuk i përkasin ndonjë dege tjetër të administratës. E drejta policore studion: shtetësinë, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e kufirit shtetëror, punët e sigurisë së përgjithshme për sigurinë e personave dhe të pronës, punët policore, tubimet publike, dokumentet e udhëtimit, të huajt, funksionet e policisë, parimet e kryerjes së kompetencave të policisë, organizimin dhe funksionimin e policisë në RM, organizimin dhe kompetencat MPB-së, azilin dhe mbrojtjen private. Në këtë lëndë përmes qasjes sistematike dhe interdisiplinare studiohen aspektet e avancuara teorike dhe praktike të zbatimit të së drejtës policore, taktikat dhe metodat moderne në zbatimin e kompetencave të policisë që të arrihet funksionimi efikas dhe efektiv i policisë në shoqërinë moderne dhe kontrolli i policisë.

- **Retorika**
  Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari i përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**
  Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi linguistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplaset me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**
  Qëllimi i kësaj lënde është: - T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. - Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Komunikimi profesional**
  Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Menaxhimi i projekteve**
  Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: - Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; - Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; - Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; - Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; - Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; - Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**
  Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëlim të aftësimit të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit sdhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**
  Qëllimet e lëndës: - Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; - Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; - Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizmit; - Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rendësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; - Të kontribon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**
  Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, me ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale; t'i nxisë studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin midis të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale; t'i vetëdijësojë për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë; t'i nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojetjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do t'i marrin parasysh në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.